



AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE TREGTARE

“AGROTURIZEM BUJTINA VJOSA ” SH.P.K.

SHEQ MUSALALAJ

FIER

DHJETOR 2022

**AKT - THEMELIMI
PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
« AGROTURIZEM BUJTINA VJOSA » shpk**

Ne Fier , sot me date 01/12/2022 ,

Altin Muskaj, atësia Veli, amësia Aferdita, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Mehmet Kallashi 01490196; Nd. 17; H. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 12/05/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Leternjoffim ID nr. 036544462 dhe nr. personal H00512072J, .

Albana Muskaj, atësia Pandeli, amësia Dafina, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në FIER, me adresë Mehmet Kallashi 01490196; Nd. 17; H. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 08/08/1976, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportes biometrike nr. BB3535277e nr. personal H65808068J, .

Marvin Muskaj, atësia Altin, amësia Albana, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në adresën Mehmet Kallashi 01490196; Nd. 17; H. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, i datëlindjes 25/04/2003, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Leternjoffim ID nr. 034269624 dhe nr. personal K30425067S

me iniciativen tone te lire si dhe duke u bazuar ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise , Kodin Civil ne fuqi , ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" , ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 «Per Qendren Kombetare te Regjistrimit » , ate Doganor , Fiskal , Tatimor vendosa te krijoj Shoqerine shqiptare me pergjegjesi te kufizuar per sa me poshte vijon :

**Neni 1
EMERTIMI I SHOQERISE**

Te formohet shoqeria tregtare shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin « **AGROTURIZEM BUJTINA VJOSA** » shpk .

**Neni 2
KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

Shoqeria « **AGROTURIZEM BUJTINA VJOSA** » shpk krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pakufizuar, mbi dhjete vjete pune te njepasnjeshme. Ky afat mund te shkurtohet per rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe do te pasqyrohen ne Statut.

**Neni 3
QENDRA E SHOQERISE**

Shoqeria « **AGROTURIZEM BUJTINA VJOSA** » shpk do te kete qendren (seline) e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise , ne adresen : Sheq Musalalaj Njesia Administrative Frakull, Bashkia Fier , Zona Kadastrale 3356 pasuria Nr. 120/20, vol. 4 , fq 3.

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon altinmuskaj777@hotmail.com



Neni 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

- **Restorant, Hoteleri**

Neni 5 REGJIMI JURIDIK

Ne te gjithë territorin e saj ne Republiken e Shqiperise Shoqeria do te udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakve te saj percaktohen me hollesisht ne Statutin qe i bashkëngjitet ketij Akti.

Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi, dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit ,sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi .

Neni 6 ORTAKET THEMELUES

Ortaket themelues te shoqerise jane ALTIN MUSKAJ, ALBANA MUSKAJ , MARVIN MUSKAJ , te cilet jane ortaket e vetem te Shoqerise .

Neni 7 KAPITALI I SHOQERISE

7/1 Kapitali baze i Shoqerise eshte :

- ne para 100.000 (njeqindmije) leke , i ndare dhe formuar ne 3 pjese. Ortaket themelues te shoqerise zoterojne sejcili nga 40% Altin Muskaj, 40% Albana Muskaj dhe 20% Marvin Muskaj te kapitalit te shoqerise me vlere kontributi ne para 100.000 leke . Kapitali do te ngurtesohet kur kjo Shoqeri te regjistrohet ne QKR .

7/2. Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe te vendimeve qe do te marrin ortakët per ta rritur ate ne te ardhmen . Kapitali do te jete 100% i ortakëve te shoqerise .

7/3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashëgimie , ne rast ndarje pasurore mes bashkeshortëve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 8 DREJTIMI I SHOQERISE

8 Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është Asambleja .

8/1 Kjo Asamble merr vendime te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas disponimeve te statutit te shoqerise .

8/2 **Shoqeria administrohet nga Administratori e saj z. MARVIN MUSKAJ** i cili do te kete kete detyre per nje periudhe 5 vjeçare me te drejte rizgjedhje .

Administratori e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

8/3 Per cdo ceshtje profesionale ,si juridike ,ekonomike ,teknike etj ,shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi

Neni 9
SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE

9/1 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi.

9/2 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administratori.

Neni 10
MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQERISE

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përfundim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

Neni 11
LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

Neni 12
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

12/1 Ky akt per Themelimin e Shoqerise ka si pjese te saj edhe Statutin e Shoqerise i cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

12/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruar edhe ky Akt - Themelimi .

12/3 Adresa ligjore e shoqerise eshte : Sheq Musalalaj Njesia Administrative Frakull, Bashkia Fier , Zona Kadastrale 3356 pasuria Nr. 120/20.

12/4 Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim ,te nenshkrhet nga ortaket e saj dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj,ashtu edhe ne QKR perkatese .

12/5 Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim , do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykaten kompetente Shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

Ky Akt Themelimi i shoqerise u printua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga une ortaku i vetem i saj me vullnet te lire dhe te plote .

ORTAKET E SHOQERISE

Albin Muskoj / Marvin Muskoj

Albana Muskoj

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
NOTER ADELINA A. PANAJOTI



DATE 01/12/2022
NR REP 1754



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 01/12/2022 , para meje Notere ADELINA A. PANAJOTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, DERVISH HEKALI, NR.17, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: Altin Muskaj, atësia Veli, amësia Aferdita, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Mehmet Kallashi 01490196; Nd. 17; H. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 12/05/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036544462 dhe nr. personal H00512072J , .

NËNSHKRUES/IT: Albana Muskaj, atësia Pandeli, amësia Dafina, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Mehmet Kallashi 01490196; Nd. 17; H. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 08/08/1976, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BB3535277 dhe nr. personal H65808068J , .

NËNSHKRUES/IT: Marvin Muskaj, atësia Altin, amësia Albana, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Mehmet Kallashi 01490196; Nd. 17; H. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 25/04/2003, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034269624 dhe nr. personal K30425067S , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Akt- themelimi i shoqrise tregëtare " **AGROTURIZEM BUJTINA VJOSA** " SHPK, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
ADELINA A. PANAJOTI